



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 19, Datë 19.01.2018

MBI

**ÇMIMIN VJETOR TË BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE, QË DO T'U
PAGUHET PRODHUESVE EKZISTUES ME PËRPARËSI TË ENERGJISË
ELEKTRIKE PËR VITIN 2018.**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, nenit 10 të Ligjit nr.7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 687, datë 22.11.2017 “Metodologjia e përcaktimit të çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi”, si dhe nenit 19 të “Rregullave të Organizimit, Funkcionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 19.01.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve në lidhje me miratimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2018,

Konstatoi se:

- Metodologjia e përcaktimit të çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për llogaritjen e këtij çmimi parashikon :
 - Çmimi vjetor i blerjes (lekë/kWh) = Çmimi mesatar vjetor i tregut të ditës në avancë (HUPX/DAM) i energjisë elektrike në profiling bandë (baseload) i vitit përkatës të bursës hungareze (HUPX) të energjisë elektrike në euro cent/kWh X bonusin për promovimin e burimeve të rinovueshme në masën 1.3 X normën mesatare të këmbimit në euro/lekë për vitin e fundit.
- Nga të dhënat e raportit vjetor të Bursës së Energjisë së Hungarisë (HUPX) rezultojnë se çmimi mesatar vjetor i tregut të ditës në avancë (HUPX/DAM) të energjisë elektrike në profiling bandë (baseload) për vitin 2017, është në vlerën 50.35 Euro/MWh.
- Nga të dhënat e publikuara nga Banka e Shqipërisë mbi kursin e këmbimit Lekë/EUR, për çdo muaj të vitit 2017 kursi mesatar i këmbimit për vitin 2017 rezultojnë 134.15 Lekë/EUR. Në rast se kursi i këmbimit Lekë/Euro që do të publikohet në Raportin Vjetor

2017 të Bankës së Shqipërisë, ndryshon nga çmimi mesatar i llogaritur, ERE rezervon të drejtën që të rishikojë llogaritjet në zbatim të metodologjisë.

- Në zbatim të formulës përlllogaritëse të pikës 3 të VKM nr. 687, datë 22.11.2017 “Metodologjia e përcaktimit të çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi”, rezulton si më poshtë :

$$\triangleright P_u=50.35/1000*1.3*134.15=8.78078825 \text{ Lekë /kWh}$$

- Paragrafët 2.ç dhe 2.d të VKM nr. 687, datë 22.11.2017 “Metodologjia e përcaktimit të çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi”, parashikojnë që, çmimi i blerjes së energjisë elektrike nga prodhuesit ekzistues me përparësi, mund të jetë jo më i ulët se çmimi i miratuar nga ERE për vitin 2016 dhe jo më i lartë se 15% e çmimit të miratuar nga ERE për vitin 2016.
- Bordi i ERE-s, me Vendimin nr. 13 datë 16.02.2016 ka vendosur që, Tarifa fikse e energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet për vitin 2016, do të jetë 7.448 lekë/kWh.
- Parashikimet e paragrafëve 2.ç dhe 2.d të VKM nr. 687, datë 22.11.2017 “Metodologjia e përcaktimit të çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi”, referuar çmimit të miratuar me Vendimin nr. 13 datë 16.02.2016 të Bordit të ERE, prodhojnë një rezultante në vlerën 8.5652 Lekë/kWh.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Çmimi vjetor i blerjes së energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2018, do të jetë 8.5652 Lekë/kWh.
2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë të interesuarit për Vendimin e Bordit të ERE.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti